

# KOSOVA NË UDHËKRYQ: DECENTRALIZIMI DHE KRIJIMI I KOMUNAVE TË REJA

Prishtinë, korrik 2009

Ky projekt është përkrahur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, Kosovë.

Përgatitur nga: Ilir Deda

Copyright © 2009 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.net](mailto:info@kipred.net) apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave  
Rexhep Mala, 5A, Kati II  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Telefon dhe Fax: +381 38 227 778  
[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

## I. Hyrje

Kosova është duke hyrë në një periudhë kritike të shtet ndërtimit e cila është qenësore për kompletimin e thelbit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshje të Ahtisarit – implementimin e decentralizimit. Zgjedhjet komunale janë planifikuar për 15 nëntor 2009. Decentralizimi dhe krijimi i komunave të reja me shumicë serbe janë qenësore për mbështetjen dhe stabilizimin e komunitetit serb në shtetin e ri dhe për thyerjen e status quo-së në pjesën veriore të Kosovës.

Që nga shpallja e pavarësisë, klima e përgjithshme e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë është përmirësuar vazhdimisht. Serbët e Kosovës gëzojnë liri të plotë të lëvizjes, siguria e tyre është duke u përmirësuar, dhe përveç në pjesën veriore të Mitrovicës, nuk ka pasur incidente të mëdha ndëretnike gjatë 18 muajve të fundit.

Qeveria e Tadiqit është duke shtrënguar kontrollin e saj mbi serbët e Kosovës duke marrë kontrollin mbi strukturat paralele duke i zëvendësuar zyrtarët lokalë të Partisë Demokratike të Serbisë (DSS) me ata të Partisë Demokratike (DS). Kjo lëvizje nuk nënkupton ndryshim të politikave, por më tepër kontroll të plotë politik, financiar dhe administrativ të institucioneve paralele serbe në Kosovë. Qeveria e Serbisë, pa e bërë shumë publike, në fillim të muajit prill 2009 kanë shpërbërë kuvendet e komunave paralele të Prishtinës të vendosura në Graçanicë dhe të Pejës të vendosura në Gorazhdevc duke emëruar anëtarët e DS që të udhëheqin “administratat e përkohshme emergjente komunale”. Në mënyrë edhe më të heshtur qeveria e Serbisë ka thirrur për zgjedhje të reja për këto dy komuna në gusht të 2009. Në të njëjtën kohë, qeveria e Serbisë ka zëvendësuar Marko Jakshiqin, ithtarin më të fuqishëm të DSS në pjesën veriore të Kosovës, dhe e shpërndau kuvendin komunal të kontrolluar nga SRS dhe DSS të komunës më veriore të Kosovës – Leposaviqit. Në të njëjtën kohë, Beogradi lejoi policët serbë të Kosovës të kthehen në Policinë e Kosovës dhe deklaroi se nuk do të përkrahë pjesëmarrjen serbe në zgjedhjet e Kosovës në nëntor.

Interesat e serbëve në veri të lumit Ibër gjithnjë e më shumë po bëhen më të dallueshme prej atyre që janë në jug të lumit Ibër. Serbët në anën jugore të lumit Ibër e shohin procesin e krijimit të komunave të reja si një opsion që do tu ofrojë atyre perspektivë për jetesë të qëndrueshme dhe zhvillim në Kosovë. Ata e shohin ndarjen si një opcion katastrofal për të ardhmen e tyre, i cili do t'i çrrënjoste nga vendbanimet e tyre. Prandaj ata janë duke i shqyrtuar mundësitë për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale. Mirëpo, para se të ndërmarrin çfarëdo hapi, një numër i udhëheqësve të komunitetit serb të Kosovës duan të sigurohen që Beogradi nuk do ti kundërshtojë haptazi për një veprim të tillë. Serbët e Kosovës të cilët jetojnë në pjesën veriore janë në një pozitë të paqartë. Një numër i tyre kanë dëshirë që të marrin pjesë në zgjedhjet komunale të Kosovës me qëllim të zotërimit formal të komunës së re të Mitrovicës Veriore, përderisa shumica e kundërshtojnë dhe janë plotësisht të varur nga udhëzimet publike apo të heshtura të Beogradit. Nëse serbët e Kosovës nuk organizohen politikisht dhe nëse i bojkotojnë zgjedhjet e ardhshme, ata rrezikojnë të humbin këtë rast unik për të vendosur për fatin e tyre.

Sidoqoftë, udhëheqësia në Beograd ka çimentuar synimin e saj strategjik për ndarjen e Kosovës pasi Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) të nxjerr një opinion këshillues në gjysmën e parë të vitit 2010 lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Udhëheqësit në Beograd besojnë se opinioni i GjND-së do të favorizojë pozitën e Serbisë,

dhe kjo do të hapë një derë për një rundë të re të negociatave me udhëheqësinë e Kosovës, i cili sipas tyre përfundimisht do të rezultonte me ndarjen e negociuar të Kosovës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) e Kosovës ka bërë përpjekje impulsive në qasjen publike dhe vendosjen e besimit me komunitetin serb për decentralizim. Mirëpo përparimi në krijimin e komunave të reja ka ngecur në kohën kur është dashur të ndërmerren masat fundamentale – krijimi me kohë i komunave të reja. Deri më tani MAPL dhe Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO) kanë certifikuar vetëm një nga gjashtë ekipet e parapara përgatitore komunale (EPK). Për më tepër qeveria nuk ka përgatitur infrastrukturën fizike për komunat e reja, që i bën shumë serbë të Kosovës të dyshojnë në seriozitetin dhe zotimin edhe të qeverisë së Kosovës dhe të Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) për decentralizim. Veç kësaj, anëtarët e qeverisë së Kosovës frikohen se nëse serbët nuk dalin në zgjedhjet komunale në veri dhe ka zbatim të suksesshëm të decentralizimit në jug, kjo do të çimentojë vijën ndarëse përgjatë lumit Ibër<sup>1</sup>.

Kjo frikë përforcohet më tutje me punën e dobët të EULEX-it në vendosjen e sundimit të ligjit në pjesën veriore të Kosovës. EULEX-i ka shfaqur më shumë tendencë të përshtatjes me situatën e tanishme në veri se sa të ndërrojë atë. Pandëshkueshmëria e cila u lejohet ekstremistëve në veri ka arritur pikën kulmore duke mos ndjekur penalisht individët të cilët kanë hapur zjarr dhe kanë gjuajtur bomba drejt policëve dhe patrullave të EULEX-it në pjesën veriore të Kosovës gjatë pranverës së 2009. Një pjesë e madhe e incidenteve nuk ishin bërë publike për opinionin për të mos shfaqur dobësinë e EULEX-it në vendosjen e sundimit të ligjit<sup>2</sup>.

Për më tepër, palët ndërkombëtare të interesit janë bllokuar nga gara e tri politikave kundërshtuese lidhur me krijimin e komunave të reja: disa prej tyre dëshirojnë krijimin e pjesshëm të komunave të reja; një pjesë tjetër dëshirojnë decentralizimin e plotë; përderisa të tjerët dëshirojnë shtyrjen e procesit deri në pranverë të vitit 2010.

Nëse ICO dhe qeveria e Kosovës nuk rikthejnë fokusin drejt serbëve lokalë dhe nuk vazhdojnë me zbatimin e decentralizimit, ata rrezikojnë të humbin besimin të cilin kanë ndërtuar me serbët e Kosovës, dhe kjo do të përforconte forcat radikale të serbëve lokalë dhe do ta fuqizonte kontrollin e Beogradit ndaj tyre për vitet në vijim. Çështje fundamentale që do të paraqitet në këtë rast është nëse bashkësia ndërkombëtare është më shumë e interesuar t'ia bëjë qejfin Serbisë se sa të jetë e zotuar për Kosovën e pavarur të unifikuar dhe shumetnike.

## **II. Serbët e Kosovës dhe Beogradi**

### **a) Implikimet e krizës financiare**

Të gjitha politikat e Serbisë lidhur me Kosovën janë të ndërlidhura me krijimin e rrethanave të favorshme në terren për Beogradin para se GjND të nxjerrë opinionin këshilldhënës lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës<sup>3</sup>. Megjithatë, ndikimi serioz i

<sup>1</sup> Intervistë e KIPRED-it me zyrtarë të lartë të MAPL, qershor 2009

<sup>2</sup> Intervista të KIPRED-it me një diplomat Evropian në Prishtinë, prill 2009; zyrtar i lartë i EULEX-it, prill 2009; këshilltar për politika i qeverisë së Kosovës, qershor 2009.

<sup>3</sup> Intervistë e KIPRED-it me një zyrtar të lartë të qeverisë së Serbisë, 16 qershor 2009

krizës globale ekonomike në Serbinë ka zbutur pozitën e ashpër të Beogradit. Serbia është duke u ballafaquar me një kapacitet gjithnjë e më të vogël të përkrahjes financiare të strukturave dhe administratës paralele të serbëve të Kosovës. Duke marrë këtë parasysh, Beogradi ka zvogëluar për 50% pagat shtesë të cilat i ka dhënë serbëve të Kosovës, dhe është në proces të zvogëlimit të konsiderueshëm të buxheteve të komunave paralele. Ky zvogëlim buxhetor do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e numrit të të punësuarve në komunat paralele për më së paku 10% - 20%<sup>4</sup>.

Në prill të vitit 2009, qeveria e Serbisë ka zvogëluar përkrahjen për rindërtimin e infrastrukturës të planifikuar për 2009 nga shuma prej €2,9 milion në shumën prej €775 mijë<sup>5</sup>. Të gjitha këto projekte i ishin dedikuar pjesës veriore të Kosovës. Në vitin 2008 Serbia ka realizuar projekte infrastrukturore në hapësirat e banuara me serbë të Kosovës në shumë totale prej €1,332,463, prej të cilave 81% (€1,07 milion) shkuan në pjesën veriore të Kosovës, dhe 19% (€256,300) në enklava<sup>6</sup>. Politikat financiare të Beogradit në thelb paraqesin politikat ndaj serbëve të Kosovës në veri dhe në jug të lumit Ibër, dhe aspiratat e saja për të mbajtur veriun nën kontroll të ngushtë. Ky dallim financiar dhe politik bie ndesh me faktin se dy të tretat e serbëve të Kosovës jetojnë në jug të lumit Ibër.

Dobësimi financiar i Beogradit i ka kthyer serbët e Kosovës të cilët gjenden në listat e pagave të qeverisë së Kosovës që të përfitojnë prej buxhetit të Kosovës, siç janë pagat për personelin e shëndetësisë dhe të arsimit. Në të njëjtën kohë një numër i të moshuarve serbë janë regjistruar për pranimin e asistencës sociale dhe pensione nga Prishtina. Për më tepër Beogradi inkurajoi serbët e Kosovës që të nënshkruajnë kontratat me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), duke zhvendosur politikat e saja dhjetëvjeçare të refuzimit të autoritetit të KEK-ut.

325 policët e suspenduar serbë të Kosovës kishin nënshkruar kontratat me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MUP) të Serbisë në prill të vitit 2009, dhe u inkorporuan në listën e pagave të MUP-it. Këta zyrtarë filluan të pranojnë nga Beogradi rreth €340 në para të gatshme<sup>7</sup>. Mirëpo Ministria e Financave e Serbisë ka anuluar këto pagesa në qershor 2009 pas kushtëzimit politik dhe financiar nga Bashkimi Evropian (BE)<sup>8</sup>. Ky ka qenë shkaktari i ndryshimit të pozitës së Serbisë lidhur me kthimin e policëve të suspenduar serbë të Kosovës në Policinë e Kosovës.

Ky zhvillim gjithashtu ka zvogëluar rëndësinë e zinxhirit autonom të komandës të policëve serbë të Kosovës siç është e paraparë me planin 6 pikësh të dakorduar midis Kombeve të Bashkuara (KB), BE-së dhe Serbisë në tetor 2008. Si rezultat i këtyre rrethanave, 318 nga 325 policë të suspenduar serbë të Kosovës janë kthyer në pozitat e tyre deri më 30 qershor 2009, i cili ishte afati i fundit të cilin u kishin dhënë Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e Kosovës dhe EULEX-i të gjithë policëve të suspenduar serbë të Kosovës, që ose të kthehen në pozitat e tyre ose të humbin punën. Sidoqoftë problemi i cili mund të paraqitet nga kthimi

---

<sup>4</sup> Intervista të KIPRED-me zyrtarë të komunës së shpërbërë paralele të Graçanicës, maj 2009.

<sup>5</sup> Izvestaj o radu Ministarstva za Kosovo i Metohiju za period 11.7.2008-31.12.2008 godine, Beograd, 3 prill 2009, f.53-54.

Shiko: <http://www.kim.sr.gov.yu/admin/article/download/files/IzvestajDrugiDeo.pdf?id=70>

<sup>6</sup> Ibid, f.55-56

<sup>7</sup> Intervista të KIPRED-it me zyrtarë të UNMIK-ut dhe policë serbë të suspenduar të Kosovës, prill/maj 2009

<sup>8</sup> Intervistë e KIPRED-it me zyrtarë të UNMIK-ut, 26 qershor 2009

i policëve të suspenduar serbë të Kosovës do të jetë ai i lojalitetit të tyre dhe i kontrollit të tërthortë të Serbisë mbi ta.

b) Qëndrimet ndaj decentralizimit

Ndikimi i krizës financiare në Serbi nuk do ta detyrojë Beogradin që të heqë dorë nga komunat paralele në Kosovë. Në prill 2009 qeveria e Serbisë i imponoi “masat e përkohshme emergjente” në “komunën e Prishtinës” (Graçanicë) dhe në “komunën e Pejës” (Gorazhdevc). Ky ishte një pasqyrim i drejtpërdrejtë i tendencës së Tadiqit për të ngritur nivelin e ndikimit të tij në pjesën qendrore dhe atë perëndimore të Kosovës. Shumë njerëz menduan se shpërbërja e dy komunave paralele do të vazhdonte me shpërbërje edhe të të gjitha komunave tjera paralele në jug të lumit Ibër, duke hapur kështu rrugën drejt pjesëmarrjes së serbëve të Kosovës në zgjedhjet lokale të Kosovës në nëntor.

Mirëpo këto supozime ishin të gabueshme. Qeveria e Serbisë ka vendosur të mbajë zgjedhje të reja lokale më 16 gusht 2009 për këto dy komuna, në pajtim me ligjin përkatës të Serbisë. Ky vendim i ka zënë në befasi edhe serbët lokalë në Graçanicë, të cilët i janë besnikë Beogradit. Veç kësaj, politikat e Beogradit për grabitje të fuqisë midis serbëve e ka prekur edhe “të paprekshmin”, Marko Jakshiq, të favorizuarin e Beogradit që nga 1999. Jakshiq u zëvendësua nga pozita e drejtorit të spitalit që gjendet në pjesën veriore të Mitrovicës nga Millan Jakovljeviq, drejtues i degës së DS për Zveçan.

Partitë politike serbe të cilat marrin pjesë në institucionet e Kosovës janë përkrahësit dhe avokuesit më të mëdhenj të krijimit të komunave të reja dhe të decentralizimit. Këto parti janë Partia e Pavarur Liberale (SLS) e cila është duke marrë pjesë në qeverinë e Kosovës, Partia Demokratike Serbe për Kosovë dhe Metohi (SDS KiM) e udhëhequr nga Sllavisha Petkoviq dhe Demokracia e Re e udhëhequr nga Branisllav Gërbiq. Ato kanë bërë përpjekje që të ngritin këtë çështje tek opinioni publik dhe të bëhen pjesë e procesit. Mirëpo besueshmëria dhe ndikimi i tyre janë të kufizuar. Këto parti u treguan të pasuksesshme në shfrytëzimin e institucioneve të qeverisë për të shtuar përkrahjen e komunitetit serb për ta.

Një numër i udhëheqësve të serbëve të Kosovës, të cilët udhëheqin strukturat paralele të Serbisë në pjesën qendrore të Kosovës, siç janë Rada Trajkoviq, Rangjel Nojkiq, Dragan Veliq dhe të tjerë, përkrahin decentralizimin dhe zgjedhjet lokale. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e tyre në zgjedhje mbetet të shihet, duke pasur parasysh dështimin e tyre për të krijuar një entitet politik, i cili do të përfaqësonte një pjesë të interesave të serbëve të Kosovës në jug të lumit Ibër. Ata janë duke ecur përgjatë një vije delikate duke u përpjekur nga njëra anë të përfitojnë përkrahjen e Tadiqit dhe në anën tjetër të kenë bashkëpunim me Prishtinën. Ky grup i udhëheqësve nuk ka kohë të mjaftueshme që të organizohet politikisht për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale.

Ndarja e Partisë Radikale Serbe (SRS) e Vojisllav Sheshelit ka ndikuar në popullaritetin e SRS edhe në Kosovë. Krahu i moderuar i SRS në Kosovë ka ndjekur Tomisllav Nikolliqin dhe Partinë e tij Përparimtare Serbe (SNS). Udhëheqësit lokalë të SNS kanë dërguar sinjale se janë të interesuar të marrin pjesë në zgjedhjet lokale në tërë Kosovën, nëse i lejon Nikolliqi<sup>9</sup>.

---

<sup>9</sup> Intervistë e KIPRED-it me një hulumtues ndërkombëtar dhe një zyrtar serb të Kosovës, mars, maj, qershor 2009

Edhe degët e Partisë Socialiste të Serbisë (SPS) më Kosovë kanë filluar të përgatiten për përkrahjen në terren të disa partive politike serbe që do të garojnë në zgjedhjet lokale<sup>10</sup>.

Degët lokale të Partisë Demokratike të Serbisë (DSS) të ish Kryeministrit serb Vjosllav Koshtunica nuk kanë pozitë të njësuar lidhur me decentralizimin. Përderisa udhëheqësi radikal i DSS në pjesën veriore Marko Jakshiq në mënyrë publike kundërshton procesin, degët në pjesën lindore dhe jugore të Kosovës janë në favor të decentralizimit. Një numër i anëtarëve të DSS kanë dhënë indikacione se do të marrin pjesë në zgjedhjet lokale duke krijuar “lista të pavarura qytetare” në pjesën lindore dhe jugore të Kosovës nëse Koshtunica vazhdon të kundërshtojë pjesëmarrjen e tyre<sup>11</sup>. Në të njëjtën kohë Marko Jakshiq dhe Millan Ivanoviq kanë “deleguar” 8 lojalistë të tyre që të aplikojnë për ekipin përgatitor komunal për Mitrovicën veriore<sup>12</sup>. Ata janë duke u bërë të vetëdijshëm se mund të humbin kontrollin mbi Mitrovicën veriore nëse shumica e shqiptarëve dhe komuniteteve tjera jo serbe të cilat jetojnë në atë hapësirë marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme lokale, apo nëse një numër i konsiderueshëm i serbëve, të cilët i kundërshtojnë ata marrin pjesë në zgjedhjet në Mitrovicën veriore.

Dy lista qytetare të serbëve të Kosovës të cilët kanë marrë pjesë më zgjedhjet komunale paralele të Serbisë më 11 maj 2008 – Vidovdan-i në pjesën qendrore të Kosovës dhe Lëvizja për Kosovë dhe Metohi në pjesën veriore të Mitrovicës, kanë hyrë në koalicion me SRS në komunat paralele. Pozita e tyre është e pazakontë pasi që kishin vendosur kontakte me MAPL duke shprehur interesimin për procesin e decentralizimit. Interesimi i tyre në procesin e decentralizimit është pasojë e mungesës së kapacitetit të komunave paralele që të kryejnë funksionet e tyre. Përfshirja e tyre e plotë në proces mbetet të shihet, dhe ata kanë dhënë sinjale gatishmërie për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale<sup>13</sup>.

Niveli i interesimit të serbëve të Kosovës në decentralizim është relativisht i lartë në krahasim me dështimin e udhëheqësve të tyre politikë që ti udhëheqin drejt krijimit të komunave të reja. Bazuar në një anketë të kryer nga Qendra për Zhvillim Social (CSD) në Graçanicë të kryer në shtator 2008 në Graçanicë, Novo Bërdë dhe Partesh me 800 respondentë<sup>14</sup> 78,8% e serbëve të Kosovës e përkrahin krijimin e komunave të reja, dhe 75,2% janë të interesuar që të informohen më shumë për procesin. Për më tepër, 52,5% mendojnë se decentralizimi do të ndikojë në cilësinë e jetesës së tyre, përderisa 56,3% mendojnë se procesi do të shtojë zhvillimin ekonomik dhe social. 50% mendojnë se decentralizimi do të përmirësojë situatën e sigurisë dhe stabilitetit të serbëve; se decentralizimi do të shtojë mundësitë e punësimit dhe të përmirësojë sistemin shëndetësor.

Udhëheqësia politike e komunitetit serb të Kosovës me mungesën e vendosmërisë së tyre janë duke rrezikuar dështimin e adresimit të kërkesave të popullatës dhe interesat ekzistenciale të komunitetit serb për krijimin e komunave të reja.

<sup>10</sup> Intervistë e KIPRED-it me një udhëheqës lokal serb, korrik 2009

<sup>11</sup> Intervistë e KIPRED-it me zyrtar të DSS në pjesën lindore të Kosovës, prill/maj 2009.

<sup>12</sup> Intervistë e KIPRED-it me MAPL, ICO, udhëheqës të komunitetit serb të Kosovës në Mitrovicën e veriut, maj/qershor 2009

<sup>13</sup> Intervista të KIPRED-it me udhëheqës të komunitetit serb në pjesën qendrore dhe veriore të Kosovës; zyrtarët ndërkombëtarë në Prishtinë dhe një përfaqësues i lartë i MAPL, shkurt/mars/maj/qershor, 2009

<sup>14</sup> 400 intervista ishin bërë në Graçanicë dhe rrethinë, përderisa nga 200 ishin bërë në Novo Bërdë dhe Partesh

### III. Prishtina dhe procesi i decentralizimit

Institucionet e Kosovës nuk kanë lëvizë me shpejtësi të mjaftueshme për të përmbushur retorikën e tyre për një Kosovë shumëetnike. MAPL ka qenë institucioni më i përfshirë në qasje publike dhe dialog me serbët e Kosovës lidhur me decentralizimin. Ministri dhe kabineti i tij janë takuar me gati të gjithë përfaqësuesit serbë të institucioneve paralele, shoqërisë civile, bizneseve dhe udhëheqësit e komunitetit. Mirëpo këto suksese të MAPL-së nuk janë përcjellë me përkrahje të ministrive tjera të qeverisë. Qeveria ka mungesë koordinimi ndër-ministritror, përderisa grupi punues ndërministror për decentralizim nuk ka arritur të zhvillojë një agjendë të njësuar qeveritare për decentralizim<sup>15</sup>.

Për më tepër mungesa e përkrahjes për MAPL ka edhe dimensionin financiar. I tërë buxheti në dispozicion të MAPL për zbatimin e decentralizimit përbëhet nga €3,3 milion për 2009. Komuniteti donator është zotuar se do ta përkrah MAPL me shumë të njëjtë. Mirëpo kjo shumë nuk mjafton për ndërtimin e objekteve komunale, gjykatave komunale dhe stacioneve komunale të policisë për komunat e reja.

Mbi të gjitha MAPL nuk ka plan të mirëfilltë për adresimin e nevojave themelore infrastrukturore për komunat e reja. Ministria ka ndarë buxhete për marrjen me qira të shtëpive private dhe shfrytëzimin e tyre si hapësira të përkohshme për kuvendet e reja komunale, për shpenzime për pajisje administrative dhe për paga<sup>16</sup>, në vend se të ndërtoj ndërtesat e kuvendeve dhe gjykatave për komunat e reja. Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit ekzistues për decentralizim i është dedikuar përkrahjes së organizata të ndryshme të shoqërisë civile të serbëve të Kosovës për të avokuar për decentralizim dhe qasje publike, rezultatet e të cilave janë të diskutueshme. Nuk ka asnjë arsye që qeveria të mos dedikoj buxhet më të lartë për decentralizimin, kur ajo është në gjendje të përkrahë zyrën administrative të KB në Mitrovicë (UAM) me €2,7 milion në vit për projekte lokale në Mitrovicë.

#### a) Ekipet përgatitore komunale

Mekanizmat e paraparë institucionalë për krijimin e komunave të reja janë ekipet përgatitore komunale (EPK). Këta trupa kanë si objektiva të përgjithshme kanë koordinimin, analizimin dhe propozimin e politikave për MAPL dhe ICO-në për zhvillimin dhe përgatitjet për krijimin e komunave të reja<sup>17</sup>. Mandati i tyre do të zgjasë deri në zgjedhjet lokale. Anëtarët e EPK-ve marrin paga mujore prej €525.00.

<sup>15</sup> Intervistë e KIPRED-it me një zyrtar të lartë të MAPL, 10 qershor 2009

<sup>16</sup> Ibid

<sup>17</sup> Detyrat kryesore të EPK janë: Vlerësimi dhe specifikimi i nevojave prioritare të komunave, duke përfshirë infrastrukturën lokale, ofrimin e shërbimeve publike dhe mbajtja e trajnimeve të nevojshme. Përgatitja e planit të punës për EPK dhe përfshirja e afateve dhe pikave referente lidhur me sukseset dhe raportet për çështjet e kompetencave komunale; Koordinimi dhe nënshkrimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit me komunat amë lidhur me shpenzimet dhe buxhetet e rezervuara të komunave të reja, dhe në koordinim me komunën amë të marrin hapat e nevojshëm për të përmbushur objektivat e planit të punës; të propozojnë struktura organizative për komunat e reja, në pajtim me ligjin e aplikueshëm; të informojnë qytetarët për komunat e reja lidhur me zhvillimet dhe të inkurajojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në zgjedhjet lokale; pas zgjedhjeve lokale të ndihmojnë në bartjen e kompetencave tek zyrtarët e zgjedhur.



Sipas Planit qeveritar të Veprimit për Zbatimin e Decentralizimit, EPK-të gjithashtu janë të ngarkuara edhe me përgatitjen e zgjedhjeve. Strategjia thotë se “EPK-të, ose një pjesë e tyre, mund të merren me përgatitje për mbajtjen e zgjedhjeve të reja komunale duke shërbyer si Ekipet Komunale të Zgjedhjeve që merret me përgatitjet teknike për zgjedhje, si caktimi i qendrave të votimit dhe sigurimi i mbarëvajtjes së zgjedhjeve”<sup>18</sup>. Megjithatë kjo detyrë e EPK-ve nuk është specifikuar në shpalljet publike për rekrutimin e anëtarëve të EPK-ve dhe gjithashtu është në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet Lokale.

Deri më 15 maj 2009 MAPL pranoi 358 aplikacione për 60 pozita, nga 10 për secilin nga EPK-të. Numri më madh i aplikacioneve ishte për EPK-të në Graçanicë dhe Kllokot. Dyzetë aplikacione erdhën për EPK-në e Mitrovicës së veriut, gati 30 prej të cilave ishin nga serbët vendorë, 8 prej të cilëve lojalistë të Marko Jakshiqit dhe Millan Ivanoviqit<sup>19</sup>. Interesimi për EPK-në e Parteshit dhe atë të Ranillukut u rrit në qershor. Gjithashtu edhe një numër i udhëheqësve lokalë të serbëve të Kosovës së fundi kanë shprehur interesimin për t’iu bashkangjitur EPK-ve. Më 18 qershor 2009 MAPL dhe ICO certifikuan EPK-në e parë në Kllokot<sup>20</sup>. Deri në korrik as qeveria e Kosovës e as ICO nuk kishin vizion të qartë se kur do të certifikoheshin pjesa e mbetur e EPK-ve.

Megjithatë serbëve lokalë nuk mund t’ju mohohet e drejta për të votuar dhe zgjedhur përfaqësuesit e tyre në komunat e reja për shkak të agjendave politike kontradiktore dhe të ngatërruara të Prishtinës, bashkësisë ndërkombëtare dhe Beogradit. I njëjti parim do të duhej të vlente edhe për shqiptarët dhe komunitetet tjera jo-serbe të cilat jetojnë në Mitrovicën veriore. Krijimi i komunës së Mitrovicës Veriore nuk do të duhej të kushtëzohet me pjesëmarrjen e serbëve lokalë në zgjedhje. Në vend të kësaj, të drejtat demokratike të qytetarëve të cilët janë duke jetuar dhe atyre të cilët kanë për qëllim të kthehen në këtë hapësirë duhet të respektohen në tërësi. Nëse shqiptarët dhe komunitetet jo-serbe fitojnë zgjedhjet komunale për shkak të bojkotit serb, përfaqësuesit e tyre politik do të duhej të qeverisnin komunën. Me apo pa pjesëmarrjen e serbëve lokalë, këto zgjedhje duhet të shënojnë fundin e mitit të lumit Ibër.

Procesi i shpalljes së pozitave për EPK-të në mediat lokale serbe ka qenë shumë i kufizuar, dhe shumë njerëz kanë mbetur të painformuar për këto vende të lira<sup>21</sup>. Gjithashtu kishte edhe tendenca nga Partia e Pavarur Liberale (SLS) për manipulim politik të krijimit të EPK-ve. Supozohet se SLS ka punuar të shpërndajë thashethemet se ata kanë përgjegjësinë për EPK-të dhe aplikacionet do të ishin të suksesshme vetëm po që se do të përkraheshin nga Partia e Pavarur Liberale<sup>22</sup>, çka dekurajoi një numër të udhëheqësve të komunitetit serb të Kosovës për t’i mos aplikuar për EPK-të.

Kjo mungesë e strategjisë mediale për informimin e qytetarëve serbë lidhur me decentralizimin si dhe tendencat për manipulim politik ndërmjet serbëve, janë një shenjë paralajmëruese për procesin e krijimit të komunave të reja. Nëse nuk i përkushtohet

<sup>18</sup> Plani i Veprimit për Zbatimin e Decentralizimit 2008-2010. Shiko <http://www.ks-gov.net/mapl/Documents/Action%20Plan%20on%20the%20Implementation%20of%20Decentralization%20eng%20final.pdf>

<sup>19</sup> Intervistë e KIPRED-it me një zyrtar të ICO-së në Mitrovicë, maj 2009; zyrtar i lartë i MAPL, qershor 2009; udhëheqës i komunitetit serb nga pjesa veriore e Mitrovicës, qershor 2009

<sup>20</sup> <http://www.ks-gov.net/mapl/News.aspx?ID=558>

<sup>21</sup> ECMI – Analiza Politike, “Decentralizimi – Themelimi i Ekipëve Planifikuese Komunale”, 5 maj, 2009

<sup>22</sup> Ibid

vëmendje e veçantë shmangies së këtyre të metave i tërë procesi i krijimit të komunave të reja do të ballafaqohet me rreziqe serioze. Prandaj qeveria e Kosovës dhe ICO-ja duhet të zhvillojnë një fond të posaçëm për përkrahjen e mbulimit të zgjedhjeve në mediat lokale serbe.

#### b) Komisioni Qendror Zgjedhor

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) i Kosovës ka filluar përgatitjet për mbajtjen e zgjedhjeve lokale në të gjithë 38 komunat, duke u bazuar në ligjet e miratuara që rrjedhin nga Plani i Ahtisarit. Roli i KQZ-së është qenësor për krijimin e kushteve të duhura administrative për mbajtjen e zgjedhjeve lokale në komunat e reja. Bazuar në Ligjin për Zgjedhje, KQZ është i vetmi institucion që ka përgjegjësinë për krijimin e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ-ve). Në anën tjetër Plani qeveritar i Veprimit për Zbatimin e Decentralizimit parashih një rol të mundshëm të EPK-ve në përgatitjen e zgjedhjeve lokale, e cila në bazë të ligjit është detyrë e KKZ-ve.

KQZ nuk është përfshirë në procesin e vendim marrjes lidhur me këtë rol të EPK-ve<sup>23</sup>. Sidoqoftë, deri më 8 korrik KQZ ka krijuar 33 Komisione Komunale Zgjedhore (30 komunat ekzistuese dhe 3 pilot komunat – Junik, Mamushë, Hani i Elezit). Vendimi për krijimin e 5 KKZ-ve – Graçanica, Kllokoti, Parteshi, Ranilluku dhe Mitrovica Veriore – varen nga vendimi politik i qeverisë së Kosovës dhe ICO-së. Çfarëdo vonesash në udhëheqjen politike nga qeveria e Kosovës dhe ICO-ja do të shkaktojë probleme në përgatitjen në kohë të zgjedhjeve për komunat e reja dhe në krijimin e kushteve për qytetarët që banojnë në këto hapësira për të ushtruar të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të qenë të zgjedhur. Për më tepër kjo vonesë do të fuqizojë zërin e Serbisë dhe do të dekurajojë serbët e Kosovës për të mos marrë pjesë në zgjedhjet lokale. Kjo do të tregojë se bashkësia ndërkombëtare është shumë më e interesuar për pozitën e Beogradit se sa nevojat ekzistenciale të serbëve të Kosovës dhe të së ardhmes së Kosovës si një shtet shumetnik.

#### IV. Implikimi i një decentralizimi të dështuar

Dështimi i mundshëm i një decentralizimi të suksesshëm këtë vit do të dërgonte drejt një rezultati negativ për Kosovën për vitet në vijim.

Ndërkombëtarisht – do të interpretohej si një dështim i institucioneve të Kosovës për të zbatuar thelbin e Propozimit të Ahtisarit – decentralizimin. Kjo do të tregonte se Kosova është një shtet, i cili nuk është i aftë të punojë drejt integritetit të pakicave të saja përbrenda kornizës së sajë institucionale. Kjo do të ndikonte negativisht edhe në pozitën e Kosovës në GjND dhe do të përforconte kundërshtimin e pesë shteteve Evropiane që e kundërshtojnë shtetësinë e Kosovës. Kjo gjithashtu do të ishte një goditje e rëndë për kredibilitetin e Zyrës Civile Ndërkombëtare dhe Grupit Ndërkombëtar Drejtues (GND), si institucionet të cilat përkrahin dhe mbikëqyrin pavarësinë e Kosovës.

Në rajon – Serbia do të arrij një përparësi strategjike për fuqizimin e agjendës së saj për ndarjen e Kosovës. Autoriteti politik i Beogradit do të përforcohet dhe ndikimi i strukturave paralele në Kosovë do të shtohet. Kjo do ta bëjë Serbinë të vetmin bashkëbisedues për

<sup>23</sup> Intervistë e KIPRED-it me një zyrtar të lartë të KQZ, 8 korrik, 2009

diskutimin e fatit të serbëve të Kosovës në të ardhmen. Në aspektin afatshkurtër shqiptarët të cilët kundërshtojnë decentralizimin do të ndjehen si fitimtarë. Mirëpo, në aspektin afatgjatë udhëheqësia e Kosovës do të detyrohet të negociojë një marrëveshje të re për akomodimin e serbëve në Kosovë, e cila do të jetë shumë më e pafavorshme se sa dispozitat e tanishme të Planit Gjithëpërfshirës për Status. Për më tepër, ky rezultat do të çojë drejt jostabilitetit më të madh rajonal dhe mund të hapë kapitullin e rinegociimit të kufijve përgjatë vijave etnike.

Përbrenda – i tërë krediti i besimit i cili është ndërtuar ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës që nga shpallja e pavarësisë do të humbet. Kjo do të diskreditojë të gjithë serbët lokalë të cilët favorizojnë bashkëpunimin me Prishtinën, do të fuqizojë forcat radikale serbe të cilat kundërshtojnë shtetin e ri dhe do të mundësojë Beogradit një kontroll të fortë mbi serbët e Kosovës.

## **V. Implikimet e një decentralizimi të suksesshëm**

Decentralizimi i suksesshëm dhe krijimi i komunave të reja nuk do të zgjedh të gjitha problemet e ndëretnike në Kosovë. Decentralizimi do të hap rrugën për një integrim afatgjatë të serbëve përbrenda kornizës shoqërore dhe institucionale të Kosovës. Gjithashtu do të jetë një hap vendimtar për zvogëlimin gradual të rolit të tanishëm negativ të Beogradit drejt shtetësisë së Kosovës dhe interesave të serbëve lokalë. Mirëpo rëndësia më e madhe e decentralizimit të suksesshëm do të jetë fillimi i një ridefinimi pozitiv të marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe serbëve.

Përbrenda – Kosova do të përballet me dy sfida të mëdha: sfida e parë do të jetë marrëdhënia e komunave të reja me institucionet e Kosovës dhe nëse ato do të respektojnë Prishtinën. Sfida e dytë do të jetë se si do të trajtojnë institucionet e Kosovës këto komuna, dmth. nëse do të trajtojnë Prishtina ato njëjtë si edhe komunat me shumicë shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë, duhet pasur parasysh se komunat paralele nuk do të shpërbëhen në një periudhë afatshkurte, mirëpo ato do të humbin gradualisht rëndësinë e tyre. Komunat e reja do të jenë institucionet kyçe lokale për ofrimin e shërbimeve – diçka që komunat paralele kanë dështuar dhe nuk janë të afta ta bëjnë. Mirëpo ndikimi i Beogradit do të mbetet në fushën e arsimit dhe shëndetësisë. Këto probleme do të rregullohen pas opinionit konsultativ të GjND-së dhe kur që të dy shtetet të fillojnë të lëvizin drejt integritetit në bashkimin Evropian.

Edhe pse nuk mund të pritët nga serbët e Kosovës që të lëvizin menjëherë drejt Prishtinës, ata do të lëvizin në masë të konsiderueshme larg tutelës së Beogradit. Përderisa të mos normalizohen marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, serbët lokalë do të përpjekën të gjejnë një modus vivendi operacional të vendosur midis Prishtinës dhe Beogradit. Duhet pasur parasysh se serbët e Kosovës që jetojnë në jug të lumit Ibër kanë treguar gatishmërinë e tyre për të pranuar dhe respektuar ligjet e Republikës së Kosovës, edhe pse publikisht nuk e miratojnë pavarësinë. Integrimi i pjesës veriore të Kosovës do të varet nga vullneti i bashkësisë ndërkombëtare që së bashku me qeverinë e Kosovës të shfrytëzojë përparësinë strategjike të cilat do t'ua ofronte decentralizimi i suksesshëm.

Në rajon – Serbia do të ballafaqohet me një goditje të fortë kundrejt strategjisë së sajë për ndarjen e Kosovës. Beogradi do të detyrohet që gradualisht ta ndryshojë qëndrimin e saj

ndaj Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Në rradhë të parë kjo do të jetë rezultat i kapaciteteve të Kosovës për të adresuar nevojat ekzistenciale të serbëve lokalë, dhe se me institucione legjitime fuqia politike e serbëve lokalë do të rritet dhe do të fitojë në besueshmëri. Kosova do të fitonte besueshmëri rajonale si një shtet që është i aftë të adresojë nevojat e komuniteteve të saja pakicë. Stabiliteti i Kosovës do të shton stabilitetin rajonal dhe do të përforcojë ruajtjen e kufijve shtetëror në rajon.

Ndërkombëtarisht – Kosova do të demonstrojë se ka vullnetin dhe është e aftë të përmbushë të gjitha obligimet të cilat rrjedhin nga Propozimi i Ahtisarit, përkundër sfidave dhe kundërshtimeve enorme. Do të shtojë në masë tejet të madhe besueshmërinë e Kosovës si një anëtar të përgjegjshëm i bashkësisë ndërkombëtare dhe do të ndikonte pozitivisht në pozitën e Kosovës në GjND. Për më tepër do të shtohet trysnia drejt pesë vendeve anëtarëve të BE-së që të moderojnë pozicionet e tyre karshi Kosovës. Kredibiliteti i GND-së dhe ICO-së do të rritet në masë të substanciale, dhe ato do të tregonin se mandati i tyre për mbikëqyrjen e pavarësisë së Kosovës është i suksesshëm.

## **VI. Rekomandimet**

KIPRED-i është i mendimit se themelimi i komunave të reja dhe krijimi i kushteve për pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në zgjedhjet komunale të 15 nëntorit 2009 është thelbësore për stabilitetin e Kosovës si shtet dhe qëndrueshmërinë e komunitetit serb.

Me qëllim të krijimit të kushteve të nevojshme për decentralizim të suksesshëm, KIPRED-i propozon rekomandimet në vijim për Qeverinë e Kosovës dhe palët ndërkombëtare të interesit:

- “Kuinti”, Zyra Ndërkombëtare Civile, Qeveria e Kosovës duhet menjëherë dhe në mënyrë të pakushtëzuar të përkrahin krijimin e komunave të reja;
- ICO dhe MAPL duhet pa vonesa të themelojnë të gjitha EPK-të për komunat e reja;
- ICO dhe Qeveria e Kosovës duhet menjëherë ti japin KQZ-së dritën e gjelbër për themelimin e komisioneve komunale zgjedhore për komunat e reja;
- Serbët e Kosovës duhet të përgatiten dhe të organizohen politikisht sa më shpejt që është e mundur për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale;
- EULEX-i dhe Policia e Kosovës duhet të dyfishojnë prezencën e tyre në pjesën veriore të Kosovës gjatë tërë procesit të zgjedhjeve;
- Qeveria e Kosovës dhe ICO-ja duhet të emërojnë zyrtarët për qeverisjen e komunave në të cilat komuniteti serb i bojkoton zgjedhjet;
- Qeveria e Kosovës dhe ICO-ja duhet të shpejtojnë procesin e ndërtimit të objekteve komunale në komunat e reja, duke përfshirë ndërtimin e gjykatave të reja lokale dhe stacioneve lokale policore;
- Qeveria e Kosovës dhe ICO-ja duhet të krijojnë një fond të veçantë për reklamimin e decentralizimit dhe përcjelljen e procesit zgjedhor nga mediat lokale të serbëve të Kosovës;
- Të respektohet rezultati i zgjedhjeve në Mitrovicën veriore, pa marrë parasysh pjesëmarrjen apo mospjesëmarrjen e serbëve lokalë.